



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2022:282942

Datë: 16.05.2024

Numri i dokumentit: 05696579

C.nr.1067/22

GJYKATA THEMELORE NE GJAKOVË-DEGA MALISHEVË, Divizioni Civil, me Gjyqtarin Nehat Qelaj, në çështjen juridike të paditësit F. U.nga fshati M., Komuna e Malishevës,të cilin e ka përfaqësuar Av. Daut Krasniqi nga Malisheva, ndaj të paditurës, Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS) Distrikti në Gjakovë të cilin e ka përfaqësuar Diellza Lukaj, sipas bazës juridike kompensim i pagave, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik me datë 16.05.2024 , merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET** në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit . U.nga fshati M., Komuna e Malishevës,.
- II. DETYROHET** e paditura Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS) Distrikti në Gjakovë, që paditësit F. U. nga fshati M., në emër të kompensimit të të ardhurave personale për shkak të ndërprerjes së marrëdhënjes së punës për periudhën kohore prej 30.04.2019 deri më datën 16.08.2023 pranë të paditurës, që do të realizonte paditësi, t’ia paguaj dhe atë trustin pensional nga punëdhënësi në shumën prej prej 2,215.20 euro, tatimin në pagë në shumën prej 995.55 euro, kamatën e përlllogaritur në shumën prej 4,766.84 euro, në total shumën e të ardhurave bruto prej **28,026.38 euro**, me kamatë prej 8% nga dita e nxjerrjes së këtij aktgjykimi datë 16.05.2024, e deri në përmbushjen definitive të detyrimit në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit të detyrueshëm.
- III. DETYROHET** e paditura që paditësit t’i paguajë shpenzimet e procedurës kontestimore, ku janë llogaritur shpenzimet në total në shumën prej 1,808.00 euro, dhe atë për përpilimin e padisë shumën prej 208.00 euro, për taksë gjyqësore 100.00 euro dhe për pesë seanca të mbajtura, secila nga 270.00 euro, në shumën prej 1,350.00 euro, për ekspertizë financiare shumën prej 150.00 euro, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas marrjes së aktgjykimit.

A r s y e t i m

Paditësi . U.nga fshati M., Komuna e Malishevës,përmes të autorizuarit të tij Av. Daut Krasniqi nga Malisheva në këtë gjykate, ka dorëzuar padi kundër të paditurës Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS) Distrikti në Gjakovë, sipas bazës juridike kompensim i pagave.

Pas shqyrtimit paraprak të padisë dhe shkresave të lëndës, gjykata sipas të dhënave të paraqitura në padi dhe shkresave lëndore ka vepruar duke i dërguar të paditurës aktvendimin për përgjigje në padi.

E paditura ka parashtruar përgjigje në padi duke e kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar, po ashtu thekson se në këtë çështje kontestuese kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës, kjo pasiqë kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar parashkruhet për tre vite nga data kur i dëmtuari ka qenë në dijeni për dëmin e shkaktuar, gjykatës i ka propozuar të refuzohet si e pa bazuar padia e paditësit.

Gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur seancat e shqyrtimit përgaditorë dhe atë të shqyrtimit kryesorë.

I autorizuari i paditësit përmes parashtrësës së datës 19.03.2024 ka bërë plotësimin dhe precizimin e padisë pas përpilimit të ekspertizës financiare pagat e pa paguara në total janë prej 28,026.38 euro dhe atë paga neto 20,048.79 euro, kontributet pensionale shumën prej 2,215.20 euro, tatimet shumën prej 995,55 euro, kamata 8% shumën prej 4,766.84 euro dhe pagat e pa paguara në shumën në total prej 20,026.38 euro me kamatë ligjore prej 8% nga data 02.02.2024 duke i propozuar gjykatës aprovimin e padisë dhe kërkesepadisë së paditësit si të bazuar duke e detyruar të paditurën në kompenzimin e shumave të lartëcekura në emër të pagave të pa paguara.

I autorizuari i paditësit Av Daut Krasniqi në senacën e shqyrtimit përgaditor ka deklaruar se mbesim ne tërësi pranë padis se paraqitur ne ketë gjykate me date 27.11.2022, dhe plotësimin dhe precizimin e saj me date 11.12.2023, paditësi ka qene ne marrëdhënie pune tek e paditura KEDS me kontratë me kohë te pacaktuar dhe i datës 01.12.2016 është larguar nga puna në mënyrë te kundërligjshme dhe një anshme nga e paditura ne kundërshtim me dispozitat e Ligjit te punës te RKS, për këtë paditësi ka zhvilluar procedurën civile ne Gjykatën Themelore ne Prishtinë e cila me aktgjykimin C.nr. 2709/2016 te datës 12.09.2019 ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit për pagesën e pagave te pa paguara dhe kthimin e tij ne vendin e punës. Kundër këtij aktgjykimi e paditura ka paraqit ankese ne gjykatën e apelit e cila e ka vërtetuar aktgjykimi e C.nr. 2709/2016 i datës 08.05.2021, një kohe të gjate e paditura nuk e ka zbatuar ketë aktgjykim. Një pjese te pagave e paditura KEDS ja ka paguar paditësit me datën 19.12.2022, për 29 muaj për periudhën 01.12.2016 e deri me 30.04.2019, me datën 16.08.2023,e ka kthyer ne vend te punës paditësin F. U. por pagat e pa paguara nuk ja ka paguar deri me tani, kërkesëpadia e paditësit është që të paguhet pagat 12.04.2019 e deri me datën 16.08.2023, e kundërshtojmë përgjigjën ne padi të paditësit pasi që padia është paraqitur ne afat për arsye se aktgjykimi i

shkalles se pare është i bere i ekzekutueshëm me date 28.05.2021, ndërsa padia është paraqitur ne vitin 2022, pastaj e paditura me date 19.12.2022, ka bere pagesën për një pjese te pagave që konsiderohet që e a pranuar borxhin përkatësisht obligimin për pagesën e pagave. Ketë e pranon edhe e paditura e cila ne përgjigje ne padi thotë se e ka përmbushur obligimin ne vitin 2022. Ne ligjin e marrëdhënieve të detyrimeve ne nenin 368 thuhet për parashkrimin par. 1 parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin dhe ne par. 2 pranimi i borxhit mund të behet jo vetëm me deklaratën e kreditorit veç se edhe ne mënyrë te tërthorta sikur janë pagesa e kësteve ose pagesa e kamatës, prandaj mbi ketë baze nuk ka parashkrim për padinë. Bazuar ne këto te dhëna i propozojmë gjykatës qe ne vazhdim te seancave te caktoj një ekspert financiar që të punoj ekspertizën e pagave te pa paguara, në fjalën përfundimtare të parashtruar me shkrim ka theksuar se gjatë seancave të shqyrtimit kryesor është vërtetuar në mënyrë të pakontestueshme se paditësi punëtor i KEDS në Prishtinë është larguar nga marrëdhënia e punës në vitin 2016 nga i padituri me të kundërligjshme që janë vërtetuar me aktgjykimin C.nr.2709/16 të datës 12.09.2019, ku është aprovuar kërkespacia e paditësit për kthimin në vendin e punës dhe pagesën e pagave të papaguara, i padituri në dhjetor të vitit 2022 ka bërë pagesën e një pjesë të pagave për periudhën prej 01.12.2016 deri më 30.04.2019, i padituri gjatë seancave nuk e ka kontestuar me asnjë provë që nuk i ka paguar paditësit pagat për periudhën prej 30.04.2019 e deri më datë 16.08.2023 kur paditësi është kthyer në vendin e punës, gjykatës i ka propozuar që paditësit ti kompenzohen pagat e pa paguara në shumën totale të tyre prej 28,026.38 euro dhe atë paga neto 20,048.79 euro, kontributet pensionale shumën prej 2,215.20 euro, tatimet shumën prej 995,55 euro, kamata 8% shumën prej 4,766.84 euro dhe pagat e pa paguara në shumën në total prej 20,026.38 euro me kamatë ligjore prej 8% nga data 02.02.2024.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë për përpilimin e padisë shumën prej 208.00 euro, për taksë gjyqësore 100.00 euro dhe për pesë seanca të mbajtura, secila nga 270.00 euro, në shumën prej 1,350.00 euro, për ekspertizë financiare shumën prej 150.00 euro e në shumën e përgjithshme prej 1,808.00 euro.

I autorizuari i të paditurës në shqyrtimin përgaditor ka deklaruar se mbesim pranë mbesim prapa përgjigjes ne padi duke kundërshtuar pretendimet e palës paditëse, fillimisht kërkojmë nga kjo gjykate që te shpallet in kompetente meqenëse dispozitat e LKP-së kane parapare qe kompetenca ne kontestet nga marrëdhënia e punës te jetë ne gjykatën ne territorin e të cilës është themeluar marrëdhënia e punës e që ne rastin konkret marrëdhënia e punës ne paditësin mes paditësit dhe të paditurit është themeluar ne Prishtinë. Atëherë konsiderojmë që kompetencë ka Gjykata Themelore ne Prishtine, pasi që e njëjta gjykatë ka marrë edhe vendimin mbi bazën e te cilit bazohet padia e paditësit. Për palët është e pa kontestueshme aktgjykimi i Gjykatës Themelore ne Prishtine me shenje C.nr. 2709/2016 i datës 17.06.2019, mirëpo e paditura ka shtjerr të gjitha mundësit ligjore të cilat ja njeh ligji me ç ‘rast edhe kërkesën e ka ekzekutuar aq sa i është aprovuar ne dispozitiv të vendimit aktgjykimi në fjalë është bërë i plotfuqishëm me datë 28.05.2021, ndërsa propozimi për përmbarim pala paditëse e ka paraqitur me date 10.06.2021, e ku i njëjti është bere i plotfuqishëm ne dhjetor te vitit 2022, paditësi përmes avokatit të tij tek e paditura kishte paraqitur kërkesë për kthim në vendin e punës ,e datë 17.01.2023, ku një kopje ja kemi dorëzuar edhe gjykatës pas marrjes se kërkesës dhe meqenëse vendimi ishte bërë i pambarueshëm pas takimit mes paditësit dhe përfaqësuesve te paditurës

është mbajtur takim me datë 14.02.2023, ndërkaq sa po i është siguruar vendi i punës paditësit e paditura kishte nxjerr vendim me datë 15.08.2023, me ç ‘rast paditësi është sistemuar ne vendin e punës si teknik rjetit. Sa i përket pretendimeve të përfaqësuesit të paditësit se lidhur me parashkrimin, parashkrimi është ndal për shkak të pranimit te borxhit konsiderojmë që në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me pranim borxhi por me ekzekutim te vendimit të gjykatës e që e njëjta është për një periudhe krejtësisht tjetër. Meqenëse se ligji e parasheh qartë se e drejta humb me lëshimin e afatit ligjor prej kur ka qenë pala në dijeni që i takon një e drejt e tillë ndërsa nuk thotë prej kur vendimi behet i ekzekutueshëm. Paditësi ka qenë ne dijeni për të drejtën e tij nga data 12.09.2019. Lidhur me propozimin për ekspertizë te njëjtën e lemë ne diskrecion të gjykatës ku ne rast se gjykata e sheh te arsyeshëm caktimin e një eksperti e paditura ka një kërkesë që eksperti te ketë parasysh se për periudhën kontestuese a ka realizuar te ardhura te tjera paditësi. Mbi bazën e krejt asaj që e u tha gjykatës i propozojmë që pas administrimit ë provave padinë e paditësit ta refuzoj si të pa bazuar, në fjalën përfundimtare të parashtruar me shkrim ka theksuar duke mbetur në tërësi pranë thënieve gjatë seancave gjyqësore, përgjigjes në padi, parashtrësive si dhe kundërshtimeve të paraqitura gjatë këtij procesi gjyqësor, duke e kundërshtuar edhe më tej kërkespadinë si për nga baza ashtu edhe për nga lartësia Pas mbajtjes së këtij shqyrtimi kryesor dhe pas administrimit të provave nuk u arrit që me asnjë provë të vetme të vërtetohet pretendimi i palës paditëse, fillimisht e paditura thekson se nuk është arritur të vërtetohet barra e përgjegjesisë, përkatësisht pretendimi i palës paditëse, se e paditura ka patur obligim ligjor që t'i kompensoj paditësit pagat e papaguara për periudhën nga data 30.04.2019 deri me datë 16.08.2023, nuk ka qenë kontestuese mes palëve se Gjykata kishte aprovuar kërkespadinë e paditësit F. U.me aktgjykimin C.nr.2079/16 të datës 29.09.2019, me të cilin aktgjykim, e paditura KEDS ishte obliguar që paditësin F.U. ta kthej në vendin e punës si dhe t'ia kompensoj pagat e papaguara nga data 01.12.2016 deri me datë 30.04.2019, e paditura kishte shfrytëzuar të drejtën e saj, e cila garantohet me Kushtetut si dhe parashihet me nenin 176 par. I të LPK-së, ashtu që brenda afatit, e paditura e kishte goditur me ankesë aktgjykimin e shkallës së parë me shenjë C.nr. 2079/16 të datës 29.09.2019, duke pasë parasysh se ankesa është mjet me efekt suspensiv, sepse me paraqitjen e saj pengohet marrja e formës së prerë të aktgjykimit, në tërësi apo në pjesën e goditur, aktgjykimi në fjalë nuk ishte bere i plotëfuqishëm dhe i ekzekutueshëm deri me datë28.05.2021, datë kjo kur aktgjykimi i shkallës sëparë, ishte vërtetuar me aktgjykimin e shkallës së dytë me shenje Ac.nr.2742/20 tëdatës 06.04.2021, paditësi permes padise kishte kërkuar kompensimin e pagave te papaguara me rastin e largimit nga puna ne mënyrë të kunderligjshme dhe i referohet periudhës nga data 30.04.2019 deri me datë16.08.2023, mirëpo, largimi nga puna i paditësit eshte bere në vitin 2016, ndërsa vendimin e gjykatës së shkallës së parë me shenjë C.nr. 2079/16 të datës 29.09.2019, e paditura e kishte përmbushur, kjo e veretuar edhe me shkresat e kesaj lënde, paditësi gabimisht pretendon se me përmbushjen e vendimit C.nr. 2079/16 të datës 29.09.2019 nga ana e të paditurës, kjo e fundit ka hyrë në obligim për të paguar borxhin për periudhën kontestuese, periudhe kjo nga data 30.04.2019 deri me datë16.08.2023, mirëpo edhe nga shkresat e lëndës, tëcilat u administruan, u vërtetua se në rastin konkret kemi të bëjmë me përmbushje të vendimit gjyqësor, pasi qëi njëjti është bërë i plotëfuqishëm, i ekzekutueshëm si dhe i përmbarueshëm, vetëm për periudhen te cilen gjykata me aktgjykim e kishte obliguar te paditure, paditësi me date 10.06.2021, kishte paraqitur propozim për përmbarim, me c'rast i njejt nga ana e gjykates ishte bere i plotefuqishëm ne dhjetor te vitit 2022, vetëm sa i përket kompensimit te pagave të papaguara, ndërsa, paditësi nuk

kishte bërë asnjëherë kërkesë për kthim në vendin e punës, përkatësisht edhe nga provat në shkresat e lëndës, u vërtetua se paditësi vetëm me datë 17.01.2023 kishte paraqitur kërkesë për kthim në vendin e punës tek e paditura, e ku me pas e paditura, pas mbajtjes së disa takimeve mes paditësit dhe përfaqësuesve të të paditurës, të paditurit kishte arritur t'i sigurote vendin e punës si teknik i rrjetit, pra, paditësi asnjëherë më parë nuk kishte bërë kërkesë për kthim në vendin e punës tek e paditura nga data 28.05.2021, kur vendimi i shkallës së dytë, kishte vërtetuar vendimin e shkallës së parë, me të cilin paditësi i kishte njohur të drejton për kthim në vendin e punës, e paditura konteston edhe lartësinë e kërkesës, duke theksuar, se paditësi gabimisht vlerëson se kompensim i takon nga data 30.04.2019 deri me kthimin e tij në punë, pasi që edhe gjykata e shkallës së parë vendimin C.nr. 2079/16 të datës 29.09.2019 i kishte njohur të drejten për kompensim nga data 01.12.2016 deri me datë 30.04.2019, ndërkaq vendimi i tillë është bërë i plotëfuqishëm vetëm me datë 25.08.2021, nga kjo qëu tha, u vërtetua se e paditura KEDS — Prishtinë nuk ka pergjegjësi në lëndimin dhe demin e shkaktuar te të paditurit, prandaj i propozojmë Gjykatës që padinë dhe kërkesë padinë ta refuzojë në tërësi si të pabazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar, ndërsa të njëjtat nuk i ka precizuar.

Për vërtetimin e gjendjes faktike, gjykata bëri shqyrtimin e këtyre provave: Ekspertizën Financiare të datës 31.01.2024, e përpiluar nga eksperti financiar B. A.- B., Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.2709/16 i datës 12.09.2019, aktgjykimin e Gjykatës së Apelit më numër AC.NR. 2742/2020 i datës 06.04.2021, vendimi e të paditurës për caktim të vendit të punës për paditësin si teknik i rrjetit nr.8076 i datës 15.08.2023, kontratat e punës nr.10207/7940 të datës 13.08.2015 dhe kontrata me nr.31010/23249 datës 14.08.2023, propozimi për përmbarim i datës 07.06.202, kontrata ... e datës 20.04.2015, vërtetimi i QPS-se nr. 30/184 datës 02.02.2024, vërtetimin tatimor në emrin e paditësit i datës 02.02.2024, kërkesa e paditësit e bërë tek e paditura me datën 17.01.2023, me numër të protokollit 231, Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë CP.nr.581/21 i datës 11.02.2022, urdhëri për përmbarim i dhënë nga Gjykata Themelore Prishtinë më numër Cpc.nr.581/21 i datës 13.12.2021.

Gjykata pas vlerësimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse, analizimit të provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku dhe ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe si të tillë e aprovoj në tërësi.

Nga aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë i datës 12.09.2019 vërtetohet se paditësi i është njohur e drejta në kthimin e punës dhe kompensimin e pagave për periudhën nga data 01.12.2019 deri më datë 30.04.2019, ndërsa nga aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës AC.nr.2742/2020 i datës 06.04.2021 konstatohet se që e njëjta ka refuzuar ankesën e të paditurës dhe ka vërtetuar aktgjykimin e lartëcekur .

Nga kontrata e punës Nr.... e nënshkruar me datë 23.03.2024 u konstatua fakti se paditësi është në marrëdhënie të punës tek e paditura i sistemuar në vendin e punës, teknik i rrjetit.

Gjykata lidhur me kompensimin e të ardhurave personale ka caktuar ekspertin financiar B. A.-B. ekspert i licencuar, i cili ka hartuar ekspertizën me datë 31.01.2024.

Nga raporti i ekspertit financiar ndër të tjera konstatohet se në bazë të përlllogaritjës së pagës bruto dhe neto të paditësit përlllogaritje e bërë sipas dy periudhave sipas aktvendimit të gjykatës për dy periudha dhe ate sipas propozimit të palës paditëse për periudhën nga data 30.04.2019 deri më datë 16.08.2023 dhe sipas propozimit të të paditurës për periudhën nga data 25.08.2021 deri më datë 16.08.2023, duke bërë llogaritjen sipas propozimit të paditësit për periudhën 30.04.2019 deri më datë 16.08.2023, të përlllogaritur sipas pagës bruto në vlerë prej 430 euro, kontributet pensionale 2,215.20 euro, tatimi në pagë 995.55 euro kamata e llogaritur në shumën prej 4,766.84 euro, e që vlera e përgjithshme rezulton të jetë 28,026.38 euro, ndërsa sipas propozimit të të paditurës për periudhën nga data 28.05.2021 deri më datë 16.08.2023 të përlllogaritur sipas pagës bruto në vlerë prej 430 euro, kontributet pensionale 1,44.36 euro, tatimi në pagë 511.71 euro kamata e llogaritur në shumën prej 1,464.90 euro, e që vlera e përgjithshme rezulton të jetë 13,480.63 euro.

Nga shqyrtimi i të gjitha provave, analizimi i deklarimeve të autorizuarve të tyre, ndërgjyqësve dhe shkresave të lëndës, gjykata konkludon se ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk është kontestues se paditësi ka pasur të themeluar marrëdhënien e punës tek e paditura KEDS, po ashtu nuk ishte kontestuese as fakti se e paditura i ndërprente marrëdhënien e punës paditësit, gjithashtu nuk është kontestuese se tani e paditura e ka kthyer paditësin në vendin e punës teknik i rrjetit sipas, aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë i datës 12.09.2019, poashtu nuk ishte kontestues se paditësi sipas të njejtit vendim i është njohur e drejta në kompenzimin e mjeteve në emër të pagave për periudhën nga data 01.12.2016 deri më datë 30.04.2019, ndërsa kontestues rezultoi fakti i mos realizimit të pagave personale nga ana e paditësit për periudhën 30.04.2019 deri më datë 16.08.2023 për shkak të ndërprerjes marrëdhënies së punës.

Andaj duke marr parasysh faktin se e paditura sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.2709/16 të datës 12.09.2019 e ka sistemuar paditësin në vendin e tij të punës si teknik i rrjetit siç u përshkrua më lart dhe duke marrë për bazë se e njëjta për periudhën nga data 01.12.2016 deri më datë 30.04.2019 i ka kompenzuar paditësit shumat e përcaktuara, ndërsa për periudhën nga data 30.04.2019 deri më datë 16.08.2023 (periudhë kontestuese) i padituri nuk është kompenzuar në emër të pagave shumat për periudhën kontestuese edhe duke marrë për bazë faktin se edhe përkundër se paditësi kthehet në vendin e tij të punës me të drejtat dhe detyrimet e plota, e paditura do të duhej ti kompenzonte pagat për muajt të cilët paditësi ishte larguar nga marrëdhënia e punës, mirëpo që në këtë rast nuk është vepruar nga e paditura, andaj kjo gjykatë vlerëson se duke marrë parasysh rrethanat e konstatuara e aprovoj kerkesë padinë e paditësit si të bazuar edhe përkundër se për periudhën si në dispozitiv të aktgjykimit paditësi nuk ishte duke punuar mirëpo sipas kësaj gjykate e paditura pas ndërprerjes së punës së paditësit do të duhej të sistemohej në vendin e tij të punës e jo ti ndërpret përfundimisht marrëdhënie e punës, kjo për faktin se paditësi ka qenë në marrëdhënie të rregullt punë tek e paditura.

Ndërsa veprimin e të paditurës me ndërprerjen të marrëdhënies së punës gjykata e konsideron kundërligjore dhe interpretim subjektiv të ligjit (*i konstatuar sipas aktgjykimit të*

Gjykatës Themelore në Prishtinë i datës 12.09.2019 dhe i vërtetuar nga aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës i datës 06.04.2021), edhe pse objekt i shqyrtimit në këtë çështje nuk është ligjshmëria e vendimeve mbi shkëputjen e marrëdhënies së punës, por kompenzimi i të ardhurave në emër të pagave të mos përmbushura, ngase lidhur me ligjshmërinë e vendimeve të të paditurës për ndërprerjen e marrëdhënies së punës është vendosur sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë të datës 12.09.2019 prandaj gjykata, bazuar në verifikimin e ligjshmërisë së atyre vendimeve dhe duke u bazuar në ekspertizën e ekspertit financiar por edhe nga provat relevante që paditësi i ka ofruar gjykatës, më rastin e caktimit të shumës për kompensimin e të ardhurave personale vendosi konformë dispozitave të Ligjit të Punës neni 80 par.1 në të cilin përcaktohet se **“Nëse gjykata konstaton se ndërprerja e kontratës së punës nga ana e punëdhënësit është joligjore, në bazë të dispozitave të këtij ligji, Kontratës Kolektive ose Kontratës së Punës, atëherë do të urdhërojë punëdhënësin që të ekzekutoj njërën prej këtyre dëmshpërblimeve”, par.1.1. **“T’i paguajë të punësuarve kompensimin, përveç shtesave dhe shumave tjera të cilat i takojnë punonjësit në bazë të këtij ligji, Kontratës së Punës, Kontratës Kolektive ose Aktit të Brendshëm, në shumën të tilla që gjykata i konsideron të drejta dhe adekuate, por të cilat nuk duhet të jenë më pak se dyfishi i vlerës së çdo dëmshpërblimi që i takon punonjësit në kohën e shkarkimit”,** par. 1.2. **“Nëse largimi nga puna vlerësohet si i paligjshëm sipas nenit 5 të këtij ligji, Gjykata mund ta rikthejë të punësuarin në vendin e tij të punës dhe urdhëron kompensimin e të gjitha pagave dhe përfitimeve tjera të humbura gjatë gjithë kohës së largimit të paligjshëm nga puna”** bazuar në gjendjen faktike dhe dispozitat e lartpërmendura gjykata vendosi që t’u aprovojë kërkesëpadinë e paditësit duke i njohur te drejtën në kompensimin e pagave dhe beneficinet tjera për periudhën nga data 30.04.2019 deri më datë 16.08.2023 (periudhë kontestuese) sipas përrllogaritjes së ekspertit financiar ekspertizë kjo e bërë sipas dy verzioneve dhe periudha të ndryshme, ku gjykata vendosi që ta aprovojë padinë sipas përrllogaritjes së bërë me propozimin e paditësit për periudhën sipas propozimit të paditësit për periudhën 30.04.2019 deri më datë 16.08.2023, të përrllogaritur sipas pagës bruto në vlerë prej 430 euro, kontributet pensionale 2,215.20 euro, tatimi në pagë 995.55 euro kamata e llogaritur në shumën prej 4,766.84 euro, e që vlera e përgjithshme rezulton të jetë 28,026.38 euro, të cilës edhe i fali besimin, pasi që sipas bindjes së kësaj gjykate nga provat e administruara u vërtetua mjaftueshëm fakti se paditësi nuk ishte kompenzuar sipas kësaj periudhe e që paditësi do t’u realizonte natyrshëm sikur të njëjtit të mos i ishte ndërprerë marrëdhënia e punës përkatësisht ti vazhdohej puna.**

Gjykata shqyrtoi edhe pretendimet e të paditurës lidhur me parashkrimin e kërkesës së paditësit por gjykata pretendimet e e tilla i konsideroi të pa bazuara ngase paditësi padinë e ka parashtruar më datë 27.12.2022, ndërsa nga shkresat e lëndës konstatohet se sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.2706/16 të datës 12.09.2019, i plotfuqishëm sipas aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.2742/2020 i datës 06.04.2021, ndërsa sipas Urdhrit për Përrmbarim CP.nr.581/21 të datës 13.12.2022 paditësi në të njëjtin vit (në vitin 2022) ka realizuar pjesërisht të drejtat nga marrëdhënia e punës, kthim në vendin e punës dhe realizimin e pagave për periudhën 01.12.2016 deri më datë 30.04.2019, andaj meqenëse paditësi në vitin 2022 ka realizuar të drejtat nga marrëdhënia e punës dhe i njëjti është kthyer në vendin e punës sipas vendimeve të lartcekura, për rrjedhojë në rastin konkret nuk ka parashkrim të kërkesës, dhe nga kjo gjendje faktike ndërlidhur me dispozitat e Ligjit të Punës Nr.03/L-212, sa

i përket kërkesave neni 87 lidhur me afatin e parashkrimit përcaktohen se **“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”**.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet e tjera të përfaqësuesit të së paditurës, dhe për gjykatën pretendimet e tilla i konsiderohen irelevante, ngase ajo nuk ofroi asnjë provë me të cilën do të mund t’ a binde gjykatën lidhur me të drejtën e saj për mos përmbushjen e detyrimit ndaj paditësit, ngase detyrimi i saj rezulton nga vendimi mbi lejimin mjeteve shtesë për detyrat e përcaktuara paditësit, ndërsa në dispozitat e nenit 7.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) është paraparë se **“Palët kanë për detyrë që të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”**, ndërsa që me nenin 7.2 të po këtij ligji decidivisht ceket se **“Gjykata është e autorizuar që t’i vërtetoj edhe faktet të cilat palët nuk i kanë paraqitur, si dhe t’i marrë provat të cilat palët nuk i kanë propozuar, vetëm po që se nga rezultati i shqyrtimit dhe i të provuarit del përfundimi se palët kanë për qëllim disponimin me kërkesat me të cilat nuk mund të disponojnë lirisht (të përcaktuar me nenin 3 par.3 të këtij ligji”**,

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori konform nenit 452.2 si dhe Rregullores për Tarifat e Avokatëve të Odës së Avokatëve të Kosovës duke detyruar të paditurin që paditësit t’ia paguajë për përpilimin e padisë shumë prej 208.00 euro, për përfaqësim në 5 seanca nga 270.00, në shumë prej 1,350.00 euro, në emër të ekspertizës financiare shumë prej 150.00 euro dhe në emër të taksës shumë prej 100.00 euro.

Lidhur me kërkesën për kamatë, Gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 382 par.1 dhe 2 të LMD-së.

Më sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, bazuar në nenin 49 dhe nenin 143 par .1 të LPK-se

**Gjykata Themelore në Gjakovë –Dega në Malishevë, Dvizioni Civil
C.nr.1067/22 me datën: 16.05.2024**

**G j y q t a r i
Nehat Qelaj**

UDHËZIMI JURIDIK: Ndaj këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit të aktgjykimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.